

**KONTRATA PUBLIKE KORNIZË**  
**622-24-5203-5-1-1/C1504**

**KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;  
dhe

**TOP PROJEKT SH.P.K., AGIM RAMADANI NR. 82/8- L. E UNIVERSITETIT, PRISHTINË**, (në vazhdim "Kontraktori"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike kornizë për Punët e riparimit/mirëmbajtjes si në vijim:

**Lyerja e brendshme dhe e jashtme ( fasadave) të objekteve shkollore të Komunës së Prizrenit - kontratë kornizë 3 vjeqare** me numër identifikues: **622-24-5203-5-1-1**

**Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e punëve të riparimit/mirëmbajtjes në vijim:

**Lyerja e brendshme dhe e jashtme ( fasadave) të objekteve shkollore të Komunës së Prizrenit - kontratë kornizë 3 vjeqare**

<i>Nr.</i>	<i>Grupi</i>
1	<b>Lyerja e brendshme dhe e jashtme ( fasadave) të objekteve shkollore të Komunës së Prizrenit - kontratë kornizë 3 vjeqare</b>

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Kontraktori, duke specifikuar listën e punëve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative . Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë punë, të përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 02. 10. 2024 dhe përfundon me 01. 10. 2027

**Neni 2 Koha e përfundimit**

2.1 Afati kohor për ekzekutimin e punëve do të jetë \_\_\_\_\_ ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i ekzekutimit të punëve do të jetë **[Shkollat e Komunsës së Prizrenit**

**Neni 3 Çmimi**

3.1 Çmimet njësi të punëve riparuese janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Kontraktuesi.

Vlera totale indikative e kontratës është **889,750.00 € (tetqind e tetëdhjetë e nënt mijë e shtatqind e pesëdhjetë euro)**. Derivimi i lejuar nga vlera totale indikative është + - 30 % e vlerës së përgjithshme të kontratës bazë.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësisve do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

#### **Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës**

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;
- (g) *[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].*

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

#### **Neni 5 Komunikimet**

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.


5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqimi, miratimi, certifikata apo vendimi do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët [ ]<sup>1</sup> në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Kontraktuesin.


<sup>1</sup> Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.

**Për Autoritetin Kontraktues**

<b>Emri:</b>	Isa Osmankaj
<b>Pozita:</b>	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	01.10.2024
<b>Vula:</b>	




*[Ne rast të kontratave me vlerë të madhe]*

<b>Emri:</b>	Z. Shaqir Totaj Kryetar
<b>Pozita:</b>	Zyrtar Kryesor Administrativ
<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	07.10.
<b>Vula:</b>	



**Për Kontraktorin**

<b>Emri:</b>	Shaban Krasniqi
<b>Pozita:</b>	Menaxher
<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	07.10.2024
<b>Vula:</b>	



**KUSHTET E VEÇANTA**  
**622-24-5203-5-1-1/C1504**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1.	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbuloen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <b>gjuha Shqipe</b> .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është <b>10% i vlerës së kontratës me vlefshmëri prej 37 muaj kalendarik.</b>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	<p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>(a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë;</li> <li>(b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre;</li> <li>(c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.</li> <li>(d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: <ul style="list-style-type: none"> <li>(i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</li> <li>(ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo</li> </ul> </li> </ul>

		ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periodha për Programin e azhurnuar është 03 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë <b>.dy dit pas hyrjes në fuqi të kontratës</b>
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë <b>36 muaj kalendarik nga data e hyrjes në fuqi të kontratës</b>
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë.  Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	<b>Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishite nga ana e Kontraktuesit,</b>
Inspektimi dhe testimi	22.1	<b>Mbikqyrës i drejtpërdrejt i menaxherit të kontratës do të jetë: Luljeta Veselaj Gutaj Drejtoreshë në DASH</b>  <b>Menaxheri i Kontratës është: Veron Aliu IDA në DASH</b>
Parapagimi		Shuma e Parapagimit është: <b>nuk ka pagese paraprake</b>
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: <b>e vlerës se kontratës.</b>
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë <b>3 ditë pas nënshkrimit të kontratës.</b>
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është <b>2 vite kalendarike pas pranimit përfundimtar të punimeve.</b>
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është <b>përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.</b>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<b>Neni 42</b> 42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periodha maksimale që jepet

		<p>për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.</p>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	<p>43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) ose vendim nga gjyqi;</li> <li>b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.</li> </ul> <p>43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>

## **AUTORITETI KONTRAKTUES**

---

**KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, Remzi Ademaj, -20000, PRIZREN,**

**Zyrtari përgjegjes i prokurimit:**

**Nr i Prokurimit: 622-24-5203-5-1-1**

### **OPERATOR EKONOMIK:**

---

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: **TOP PROJEKT SH.P.K., AGIM RAMADANI NR. 82/8- L. E  
UNIVERSITETIT, -, PRISHTINË, Kosovë**

E-mail: **topprojekt@gmail.com**

Personi kontaktues: **Shaban Krasniqi**

Telefoni: **049/938442**

Faxi:

Numri fiskal: **811930537**

**Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):**

## FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

### Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 622-24-5203-5-1-1

**Titulli i kontratës: Lyerja e brendshme dhe e jashtme ( fasadave) të objekteve shkollore të Komunës së Prizrenit - kontratë kornizë 3 vjeqare**

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

**1 Lyerja e brendshme dhe e jashtme ( fasadave) të objekteve shkollore të Komunës së Prizrenit - kontratë kornizë 3 vjeqare**

3. Çmimi total i tenderit është:

**889,750.00 EUR**

Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: **120** nga data finale për dorëzim të tenderëve.
5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës
6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender *[shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet]* si partner në konsorcium të udhëhequr nga *[shëno emrin e udhëheqësit]*. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.
7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK






### Drejtoria Komunale e Arsimit

#### PARAMASA DHE PARALLOGARIA

OBJEKTI: Lyerja e brendshme dhe e jashtme e objekteve shkollore

VENDI: shkollat fillore dhe të mesme në Komunën e Prizrenit

	përshkrimi i punimeve	njësia	sasia	çmimi	totali	
1	Demolimi, gerryja dhe pastrimi i suvalimit të vjetër, nga muret dhe plafonet, aty ku verchen plasaritje dhe shtresa të pa qëndrueshme. Materiali i demoluar të largohet deri në deponi.	m <sup>2</sup>	30,000.00	0.50 €	15,000.00 €	✓
2	Furnizimi me material dhe lyerja e mureve dhe plafoneve me bazë të depertimit të thellë në sipërfaqet ku ka nevoj të renovohet plotësisht si dhe në sipërfaqet ku ka nevoj të punohet vetëm me patinim (glet).	m <sup>2</sup>	30,000.00	0.50 €	15,000.00 €	✓
3	Furnizimi me material dhe suvalimi i të gjitha sipërfaqeve të nevojshme me të gjitha fazat e suvalimit: Llaç çimentoje, rrjete, masë rrafshuese dhe patinim (glet) final.	m <sup>2</sup>	40,000.00	2.40 €	96,000.00 €	✓
4	Furnizimi me material dhe patinimi (gletimi) i nevojshëm i sipërfaqeve të mureve dhe plafoneve. Në çmim duhet të llogaritet edhe gryerja e nevojshme e sipërfaqeve të mureve dhe plafoneve, para se ato të patinohen.	m <sup>2</sup>	60,000.00	2.40 €	144,000.00 €	✓
5	Furnizimi me material dhe lyerja e sipërfaqeve të mureve dhe plafoneve me ngjyrë polikollor me një shtresë impregnuese dhe dy shtresa me ngjyrë disperzive. Në çmim duhet të llogaritet edhe gryerja e nevojshme e sipërfaqeve të mureve dhe plafoneve, para se ato të lyhen. Nuanca e ngjyrës sipas kërkesës së investitorit	m <sup>2</sup>	120,000.00	2.40 €	288,000.00 €	✓



6	Furnizimi, transporti dhe punimi i këndeve apo qosheve te prodhuesit KNAUF ose te ngjashem. Kujdes I veqante duhet ti kushtohet montimit te kendeve.	m'	1,500.00	0.50 €	750.00 €	✓
7	Demolimi dhe pastrimi I shtresave te demtuara nga fasadimi ne objektet ku do te punohet, duke perfshir gjitha shtresat deri ne sipërfaqe e rrafshl te murit. Materialet e demoluara të deponohen në deponi e materialve inerte.	m <sup>2</sup>	10,000.00	1.00 €	10,000.00 €	✓
8	Furnizim dhe punimi I materialit dhe ngjyrosja e mureve me fluid - ngjilës (bazë lidhëse-beton kontakt)	m <sup>2</sup>	10,000.00	1.00 €	10,000.00 €	✓
9	Furnizimi dhe montimi i pllakave nga Stiroporit me peshe vellimore 80 kg/m <sup>3</sup> ne fasade te objektit me trashësi l=50mm deri ne t=100mm. Pllakat te ngjiten me ngjilës ndërlimor dhe tiplla (min. 8 tiplla/m <sup>2</sup> ndersa kende deri ne 14 tiplla/m <sup>2</sup> ) duke respektuar udhëzimet e prodhuesit. Ne çmim te kalkulohen edhe te gjitha profilet metalike te nevojshëm për këtë lloj fasade (U, L-profilet).	m <sup>2</sup>	10,000.00	7.00 €	70,000.00 €	✓
10	Furnizimi me material dhe montimi i rrjetës Rabic me shtresën e ngjilësit ne sipërfaqen e punuar nga Stiropori. Shtangimi i rrjetës dhe vendosja e ngjilësit te behet sipas udhëzimeve te prodhuesit minimum dy shtresa ngjiles.	m <sup>2</sup>	10,000.00	3.00 €	30,000.00 €	✓
11	Furnizim me material, shtresa e ngjilësit rrafshues Përfshi patenimin sipërfaqësor, (shtresa nga masa rrafshuese), dhe aksesoret standard për kompletme lineare dhe sipërfaqësore.	m <sup>2</sup>	10,000.00	3.00 €	30,000.00 €	✓
12	Pergaditja dhe lyerja e mureve të fasadës me shtresen baze per fasade dekorative.	m'	10,000.00	1.00 €	10,000.00 €	✓
13	Furnizimi me material dhe punimi i Fasadës në pjesën e jashteme ,fasada me granulë 1.5-2mm e ngjyrosur - ipet e gatshme, material i klasit te pare	m <sup>2</sup>	3,000.00	3.00 €	9,000.00 €	✓



14	Furnizimi me material dhe punimi i mureve te cokles të objekteve, me material guror me leng ngjites, (shtresa nga koliri). Kjo lloj fasade vendoset mbi nivelin +00 max 1.50 m'.	m <sup>2</sup>	3,000.00	3.00 €	9,000.00 €	✓
15	Furnizim, montim dhe punim-ngjyrosja e mureve te fasades me ngjyre Fasadex e bardh -plastik dhe me ngjyre yndyore -plastik me pigmente te mbyllta sipas perzgjedhjes së organit mbikqyrës ose nuansa sipas pozicioneve ekzistuese.	m <sup>2</sup>	30,000.00	3.50 €	105,000.00 €	✓
16	Pastrimi, gerryerja dhe ngjyrosja e konstruksioneve metalike ne hapeseirat per shume qellime dhe sallat e edukates fizike me ngjyre baze qe mbron nga korozioni dhe dy shtresa ngjyre yndyore. Paraprakisht duhet te behet inspektimii i gjendjes ekzistuese te strukturave te qelikut, inspeklimi vizual dhe penetrant - para ngjyrosjes te perpunohet raporti i gjendjes faktike te strukturave nga inxhinieri perkates kompetent dhe nese ka nevoje te saldohet (perforcohet). Ne llogari te parashifen skelet, mjetet, elementet lidhese dhe te gjitha punet dhe materialet tjera te nevojshme per ekzekutim. Llogaria te behet per kg te materialit te perdorur	kg	48,000.00	1.00 €	48,000.00 €	✓
			gjithsej		<b>889,750.00</b>	




Vërejtje: ne cmimi duhet te llogaritet edhe;

A. per lyerjen e brendshme te objektit;

1. TVSH-ja,
2. Largimi (barlja) e inventarit para fillimit të punimeve dhe kthimi i të njejtave pas kryerjes së punimeve,
3. Pastrimi i mureve te brendshme me tretës nga të shkruarat me ngjyrë të cilat nuk mund të mbulohen nga ngjyra e re - polikolori.
4. pastrimi i hapësirave pas lyerjes - kthimi hapësirave në gjendje të rregullt, 5. Masat mbrojtëse, izolime dhe mbeshjtjellje e inventarit, dyerve, dritareve dyshemeve etje, për mbrojtjen e ambientit ne hapsirat ku do te punohet,
5. skelet dhe sherbimet tjera te nevojshme per kryerjen e te gjilha punimeve.

B. per lyerjen e jashtme te objektit;

1. TVSH-ja,
2. sigurimi dhe rrethimi i punishtes me rrethojë të sigurtë për të pamundësuar çasjen e personave te pa autorizuar brenda vendpunishtes per arsye se punimet bëhen ne lartesi. Si dhe te vendoset dera per hyrje ne punishte, vendosja e shenjave lajmeruese,
3. Masat mbrojtëse, izolime dhe mbeshjtjellje e dyerve, dritareve etj, për mbrojtjen e ambientit ne hapsirat ku do te punohet. dhe pas përfundimit të punimeve të kthehen ne gjendjen e meparshme, 4. Furnizimi, transporti dhe montimi i Skelerise se nevojshme gjate gjilhe punimeve. E njejta duhet te largohet pas përfundimit te punimeve,
5. Pas përfundimit te projektit te largohen te gjilha materialet e vendosura ne sherbim te punimeve, te behet pastrimi gjeneral i punishtes, me largim te materialit deri ne deponi,





# ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

## Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. **131581**

Për **Kuvendi Komunal i Prizrenit**

( Emri i "Autoritetit Kontraktues" )

Në emër të **TOP PROJEKT SH.P.K.**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Lyerja e brendshme dhe e jashtme ( fasadave) të objekteve shkollore të Komunës së Prizrenit - kontratë kornizë 3 vjeqare**

Nr. prokurimit: 622-24-5203-5-1-1 , Nr. brendshëm: 622-24-092-5-1-1

### Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t`i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **88,975.00€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **88,975.00€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 1125 ditë kalendarike prej **30.09.2024** deri më **30.10.2027**

Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit të Garancionit, Siguruesit/Garantuesit i kalon e drejta për ta rimbursuar nga i Siguruari/Kontraktuesi shumën e paguar përfituesit, me të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore deri në përmbushjen e tërësishme të detyrimeve.

Data lëshimit: 30.09.2024

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG) botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.





# ELSIG

Gjithcka që duhet ta keni

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.  
Kompania e sigurimeve ELSIG sh.a., Prishtinë, Adresa: Rr. "Tringë Ismajli"-nr,19,  
Tel: +383 (0) 38 221 112; Fax: +383 (0) 38 221 115, E-mail: office@kelsig.com



## POLICË PËR SIGURIMIN E GARANCISË SË EKZEKUTIMIT TË KONTRATËS

Nr. Polices: **131581**

Kontraktuesi	
Emri	TOP PROJEKT SH.P.K.
Përfaqësuar nga	Shaban Krasniqi
Adresa	Prishtinë, Rr. Ahmet Gashi BL.C-1 Hy.5, Nr.5
Nr i Biznesit	811930537
Telefoni	049938442
Përfituesi	
Emri	Kuvendi Komunal i Prizrenit
Adresa	Prizren
Garantuesi	
Emri	Elsig
Banka Garantuesit	NLB
Mbulueshmëria e Polices	
Shuma Siguruar	88,975.00
Periudha Sigurimit	30.09.2024 - 30.10.2027
Primi	4,936.29
Tvsh	888.53
Primi Bruto	5,824.82
Data e lëshimit	30.09.2024 16:51
<b>Aktiviteti Ekonomik:</b> Lyerja e brendshme dhe e jashtme (fasadave) të objekteve shkollore të Komunës së Prizrenit - kontratë kornizë 3 vjeqare	

### Lënda e Garancisë

Detyrimet e Siguruesit ndaj Përfituesit sipas kësaj Police të sigurimit janë:

- Mbështetur në këtë Police - Garancie, Siguruesi / Garantuesi merre përsipër që të plotësojë çdo detyrim kontraktori i cili është i garantuar me këtë police.
- Përfituesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit / Garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të Siguruarit / Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.
- Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit, Siguruesit/Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguruarit/Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj përfituesit (cedimi i të drejtave nga Përfituesi të Siguruesit/Garantuesit).
- Ky sigurim është lidhur sipas Kushteve të përgjithshme të Sigurimit të Garancive dhe ekzekutimit të kontratës të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Police.
- Për polica të sigurimit - Ekzekutimi i kontratave - pjesë përbërëse e kësaj police është kontrata e ekzekutimit të punëve ndërmjet autoritetit kontraktues (Përfituesi) dhe Operatori Ekzekutues (të Siguruarit) di dhe marrëveshja e lidhur në mes Siguruesit dhe Operatorit Ekonomik (hipoteka e lënë peng)

Me nënshkrimin e kësaj kontrate pajtohem që Kompania e Sigurimit ti ruaj të dhënat e mia personale / të dhënat e biznesit, të cilat do të përdoren nga Kompania për qëllime statistikore, hulumtim/raportim në Regjistrin Kreditor të Kosovës si dhe transferim tek një palë e tretë me qëllim të trajtimit të dëmeve.

Me nënshkrimin e kësaj police të sigurimit, nënkuptohet se unë i siguruari me vullnet të lirë, të barabartë dhe me mirëbesim kam pranuar primin e sigurimit, kam lexuar, kuptuar dhe pranuar kushtet e sigurimit.  
My signature in this insurance policy signifies that I the insured with good will have accepted the insurance premium. I have read, understood and accepted the insurance terms and conditions



Kompania e Sigurimeve Elsig  
Leudona Balaj - 2569



Përfaqësuesi i të siguruarit  
Shaban Krasniqi

**FATURË - 0919767**

Kos-GIRO

<b>Klienti</b>	TOP PROJEKT SH.P.K.	Id e pageses Elsig	000082
<b>Adresa</b>	Prishtinë, Rr. Ahmet Gashi BL.C-1 Hy.5, Nr.5	Nr i references	510256960919767P
<b>Telefoni</b>	049938442	Prej llogarisë	0000000000000098
<b>Nr Identifikues</b>	811930537	Llogaria Elsig	1901299635031385 (BKT)
		Nr fatures	0919767
		Kësti	1 / 1

Njësia org.	Data e faturës	Afati i pagesës	Nr referencës	Referenti juaj
Zyret qendrore	30.09.2024	30.09.2024	510256960919767P	Leudona Balaj (2569)


Nr policës	Përshkrimi	Çmimi pa tvsh	Tvsh	Vlera me tvsh
0131581	Garancionet	4,936.29	888.53	5,824.82

Vlera pa tvsh	4,936.29 EUR
Tvsh perqindja	18.00 %
Tvsh vlera	888.53 EUR
Vlera për pagesë	5,824.82 EUR

Ju lutem e shënoni numrin e referencës 510256960919767P si referencë për pagesë

Në rast të mospagesës së kësaj fature në afatin e paraparë, atëherë KS "Elsig" sh.a, do ta shfrytëzoj të drejtën e saj që pagesën ta realizoj në bazë të ligjit për Procedurën Përmbartimore të Republikës së Kosovës.

Kjo faturë është e vlefshme pa vulë!

**Faturoi**  
Leudona Balaj**Pranoi**  
TOP PROJEKT SH.P.K.

669955978 30.09.2024 16:59:42

**Pagesë e faturave / Bill Payments**

Nr. i llogarisë / Account No: XK051110343873000157  
Emri i llogarisë / Account name: TOP PROJEKT SHPK  
Emri tregtar / Commercial name: NNSH TOP PROJEKT  
Kodi Utilitar / Utility Code: 16 ELSIG SHA – GIRO VULLNETARE 1901299635031385  
Referenca e pagesës / Payment reference: 510256960919767P  
Shuma / Amount: 5,824.82 EUR  
Provizioni / Commission: 0.80  
Shuma totale / Total amount: 5,825.62  
Data / Date: 30.09.2024  
Pershkrimi i pagesës / Payment description: Garancionet

**CONFIRMED**

Date: 30.09.2024

 ProCredit Bank